



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGETIKES
DREJTORIA E SHERBIMEVE JURIDIKE

URDHER

Nr. 766 Date 08/09/2009

Ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, te nenit 4, 5 dhe 9 te te ligjit nr.10 134, date 11.05.2009 "Per krijimin e Qendres se Panairove dhe te Ekspozitave Tregtare", Ligjit nr. Nr.9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe vendimit nr.139, datë 13.2.2008, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse, për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës",te

URDHEROJ:

1. Pjesemarrjen e shtetit ne shoqerine Qendra e Panairove te Ekspozitave Tregtare, me ortak i perfaqesuari i tij, Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energetikes.
2. Pjesemarrja e shtetit ne kete shoqeri do te jete me vleren e siperfaqes se truallit prej 17.69 ha.
3. Vlera e siperfaqes, sipas pikes 2, te llogaritet ne referim te ligjit ne fuqi.
4. Per zbatimin e ketij urdheri ngarkohet Drejtoria e Administrimit te Prones Publike.
5. Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

MINISTRI

GENCRULI

